



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:081842
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05712097

Ac.nr.6195/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi – Kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Shpëtim Azemi në çështjen juridike –kontestimore të paditëses E.Y. nga fshati ...- Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson i autorizuari M.M., avokat në Gjilan, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve(BKS) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar L.R., juriste nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, duke vendosur në lidhje me ankesën e përfaqësuesit të të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan –Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.764/2020, të datës 28.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan –Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.764/2020, të datës 28.05.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.764/2020, i datë 28.05.2021 ka vendosur si në vijim:

“ **I. MIRATOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.Y. nga fshati..., Komuna e Vitisë, **DETYROHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, që paditëses t`ia kompensoj dëmin material të formës së fitimit të humbur – rentës dhe atë: Për periudhën e kaluar prej aksidentit me datë 17.08.2014 e deri më datë 31.03.2021 shumën prej 5,418 euro, ku së

bashku me kamatën e llogaritur në normë prej 8% në vit, e sipas arritjeve mujore për pagesë prej ditës së ushtrimit të padisë me 03.12.2014 e deri më 31.03.2021 (datë e nxjerrjes së ekspertizës së aktuarit), shumën e kamatës prej 1,830 €, e në total fitimi i humbur dhe kamata në shumë prej 7,248 euro.

- Kurse për periudhën e ardhshme prej 01.04.2021 e në vazhdim deri në Shkurt të vitit 2026, kur me riezaminim mjekësor duhet rivlerësuar invaliditetin punues, renta mujore arrinë në 42.50 €, e cila po të paguhej në formë të menjëhershme apo të kapitalizuar për të njëjtën periudhë arrinë shumën prej 2,886.60 euro.

- Ndërsa pas muajit Shkurt 2026, tek paditësja do të rivlerësohet shkalla e invaliditetit punues, ashtu që mbi bazën e rivlerësimit do t'i caktohet renta e re mujore.

II. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve, që paditëses E.Y., në emër të shpenzimeve materiale, të faturave për barna dhe shërbime tjera mjekësore, t'ia kompensoj shumën prej 4,310 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data ushtrimit të padisë më 03.12.2014 deri në pagesën definitive.

III. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve, që paditëses ME.Y. t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: 104 euro për përpilimin e padisë, 100 euro për pagimin e taksës në padi, 2,974.40 € për përfaqësim të avokatit në 11 seanca gjyqësore secila nga 270 €, dhe 750 euro për shpërblimin e 5 ekspertizave, apo gjithsejtë 3,928.40 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ”

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesit i të paditurës në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta' aprovojë ankesën, ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë, ta refuzojë si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Në afat ligjor, përgjigje në ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i paditëses, më propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar, dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e përfaqësuesit të të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me datë 03.12.2014, përmes të autorizuarit të saj, në Gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material, më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, dhe shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.764/2020, i datës 28.05.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, Gjykata e shkallës së parë, mes tjerash thekson se baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar nga raporti i aksidentit të komunikacionit të policisë nr.2014-CF-245, Aktgjykimi Penal P.nr.496/2014 i datës 22.08.2014, kurse për caktimin e lartësisë së kërkesëpadisë kishte vendosur në bazë të mendimit të ekspertit të aktuaristikës Prof.A.B., ekspertizës së mjekës ortoped-reumatologe Dr.V.B., si dhe ekspertizës së ekspertit të lëmisë së punës Dr.Xh.Sh.

Tutje kishte theksuar se, Nuk duhet lënë anash edhe argumentimin dhe arsyetimin e palës paditëse, lidhur me shpenzimeve materiale, të faturave për barna dhe shërbime tjera mjekësore, të gjykuar në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku i autorizuari i paditëses në mënyrë specifike i kishte paraqitur provat që e arsyetojnë këtë formë kompensuese, duke i dorëzuar në origjinal si raporti i fiziatrit pranë ordinances specialistike për mjekësi fizikale dhe rehabilitim "A..." në Kllokot. Gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar se ekspertët përveç se konstatuan gjendjen shëndetësore të pas aksidentit për paditësen, të cilën e paraqitën me ditë, javë dhe muaj, ata ishin deklaruar se edhe në të ardhmen gjendja shëndetësore, respektivisht paaftësia punuese tek paditësja do të përmirësohet në shkallë të ulët, andaj ajo edhe punët më të lehta të amvisnisë do t'i kryej me vështirësi të theksuara.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452.2 dhe 453.1 të LPK-së dhe tarifës zyrtare për përfaqësime.

Vendimin e saj Gjykata e ka mbështetur në nenin 143 të LPK-së, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e drejta materiale është aplikuar drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Pala e paditur ankesën e ka parashtruar nga të gjitha bazat, mirëpo në raport me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nuk ka specifikuar ansjë shkelje konkrete, andaj në raste të tilla Gjykata e Apelit me rastin e ekzaminimit të aktgjykimit të atakuar nuk ka gjetur se i njëjti është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës në pikat për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Po ashtu, Gjykata ankimore vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike për faktin se nga vlerësimi dhe administrimi i provave është vërtetuar se ekziston baza juridike e kërkesëpadisë, pasi që baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar me aktgjykimin paraprak për kompensimin e dëmit për dhimbje fizike, frikë etj, ku Gjykata e Apelit vetëm ka ndryshuar lartësinë e kompensimit, ndërsa baza ka mbetur e vërtetuar, andaj në raport me shëmtimin dhe rentën është vërtetuar me ekspertiza mjekësore nga lëmia e ortopedisë, mjekësisë së punës si dhe në raport me lartësinë e rentës është vërtetuar në bazë të ekspertizës së aktuaristikës. E paditura në ankesë në raport me gjendjen faktike e godet ekspertizën mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe asaj të mjekësisë, e poashtu edhe ekspertizën e aktuaristikës ndërsa në procedurë në shkallë të parë nuk ka pasur vërejtje në raport me këto ekspertiza përveç faktit që ka pretendu se paditëses nuk i takon renta sepse zvogëlimi i aktivitetit është nën 30 %. Ekspertizat mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe ajo e mjekësisë së punës pasqyrojnë një mendim objektiv, profesional dhe janë në përputhje me shkresat e lëndës, praktikën gjyqësore dhe faktit se paditësja është e paaftë për pjesën e punëve nga të cilat varet lëvizja precize e dorës, ngritja e peshave, mbajtja e peshave sidomos me dorë të djathtë, e që

rezulton se dora e djathtë e të njëjtës është dora dominuese, pra të njëjtën e bënë të paaftë për një mori punësh. Fitimi i humbur respektivisht renta nga dita e aksidentit e deri në hartimin e ekspertizës aktuaristike drejtë është llogaritur në lartësië prej 4,418 euro.

Baza juridike e kërkesëpadisë bazohet në nenin 136, 140, 159, 172, 173, 179 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (ligji i vitit 1978 pasi aksidenti ka ndodhur në kohën kur ka qenë në fuqi ligji në fjalë).

Me nenin 136 të LMD-së përcaktohet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”*, ndërsa me nenin 140 përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”*

Me nenin 159.1 të LMD-së (Ligji i vjetër) parashihet se: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë.”* Ndërsa me nenin 172 të LMD-së paragrafi i parë parashihet se: *“1. Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. 2. Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se Gjykata nuk cakton diç tjetër.”*

Me nenin 173 të LMD-së parashihet se: *“I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.”*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave pa mëdyshje vërtetohet fakti se e paditura ka për obligim që t’ia kompensojë paditëses kompensimin e dëmit material në formë të rentës për shkak të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në aksident, të shkaktuar me fajin apo pakujdesinë e personit të tretë, dëmin e të cili duhet t’a kompensojë e paditura sepse i njëjti nuk ka pasur sigurim të automjetit, ndërsa lartësia e kompensimit është caktuar në bazë të mendimit të ekspertit të aktuaristikes.

Vendimi mbi kamatën është në përputhje me nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit 449, 450, 452 të LPK-së, dhe se nuk qëndron pretendimi ankimor se kjo duhet të llogaritet në bazë të suksesit në procedurë pasi e paditura i ka dhënë shkas paditëses në paraqitjen e padisë.

Gjykata ankimore i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6195/2021 me datë 07.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Faton Ademi, d.v